



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.119/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5. 100 (pasmijenjiqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 03.10.2017, me të cilën pretendon se subjekti politik LVV, për qëllime elektorale në sheshin "Zahir Pajaziti", kanë vendosur një objekt-kioskë e cila është në kundërshtim me nenin 33 pika b e LZP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV, të datës 04.10.2017, theksoi se Subjekti politik LVV, sipas nenit 4 të Rregullës së KQZ-së nr. 13/2013 ka dorëzuar Formularin e Njoftimit të tubimit publik tek Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve-ZLKZ për miratim, dhe i njëjti ka lejuar vendosjen e tendës në shesh nga ana e LVV-së. Pas pranimit të urdhrimit për përmirësim, LVV nuk kanë ndërmarrë masat përmirësuese, duke u arsyetuar se të njëjtit posedojnë leje nga KKZ për vendosje, dhe për të dëshmuar pretendimet e tyre, përgjigjes i kanë bashkangjitur kopjen e Formularit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, është bërë shkelja e Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, tendat e vendosura në hapësira publike, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen ka mohuar shkeljen e supozuar. Pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë.

Nga parashtrësia e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës e datës 05.10.2017, paneli konstaton se parashtruesi i ankesës e ka plotësuar brenda afatit ligjor formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit publik, i cili tubim publik është lejuar nga KKZ-ja në Prishtinë, nga data 30.09.2017 deri më 20.10.2017 nga ora 11:00-21:00 në Prishtinë.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara, ka rezultuar se zyrtari i lartë i Komisionit Komunal të zgjedhjeve, e ka miratuar kërkesën e subjektit politik LVV për mbajtjen e tubimit publik, dhe ka lejuar vendosjen e tendës në hapësirë publike nga data 30.09.2017 deri më 20.10.2017 nga ora 11:00-21:00, mirpo këto veprime sipas vlerësimit të Panelit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore Neni 33 pika b) i LZP-së si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013.

Paneli po ashtu vlerësoi dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 119/2017 më datën 10.10.2017



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdë Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.